

GJËRA BASHKËKOHORE
QË (S')E
PRISHIN AGJËRIMIN



prof. dr. *Ahmed el Halili*

Përshtati në shqip:

Agren Krasniqi

Gjëra bashkëkohore që (s')e prishin agjërimin

Autor:

prof. dr. Ahmed Muhamed el Halili

*profesor në studimet e larta në Universitetin e
Kasimit, Arabi Saudite*

Përshtati në shqip:

Agron Milazim Krasniqi

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, Krijuesit të gjithësisë, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, ndërsa paqja dhe lavdërimi i Tij qofshin mbi të Dërguarin e Tij Muhamed, mbi familjen, shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që pasojnë rrugën e tij deri në Ditën e Fundit!

Më pas, kjo është një përmbledhje e disa çështjeve bashkëkohore që mund të kenë ndikim në agjërime, gjegjësisht konkluzione që i ka përmendur prof. dr. Ahmed ibn Muhamed el Halili në libërthin e tij *“Gjërat bashkëkohore që e prishin agjërimin”* (مفطرات الصيام (المعاصرة)) i cili i ka trajtuar gjerësisht në librin në fjalë.

E pashë të nevojshme që t’i përkthej si konkluzione, pa u zgjeruar në theksimin e diskutimeve apo argumentimeve të dijetarëve, ngase, siç dihet, në disa prej tyre ka më shumë se një mendim, mirëpo, në përgjithësi, autori ka qenë i kujdesshëm në përzgjedhje, andaj në shumë syresh përmend edhe mendimet e komisioneve dhe dijetarëve të njohur. E lus Allahun që kjo përmbledhje të jetë e dobishme.

Në vijim po jua sjellim disa prej konkluzioneve në fjalë.

Gjëra bashkëkohore që (s')e prishin agjërimin

1. Sipas mendimit më të saktë, mbështetur në argumente, qëndron se, stomaku (lukthi) është brendësia e vetme e trupit që, nëse në të hyn diç prej ushqimit, agjërimi konsiderohet **i prishur**, e jo ndonjë brendësi tjetër.

2. Mendimi më i saktë është se, spreji i astmës, që përdoret kundër astmës për lehtësimin e frymëmarrjes, **nuk e prish** agjërimin.

Ky është mendimi i Komisionit të Përhershëm, si dhe i Ibn Bazit, Ibn Uthejmit, Ibn Xhibrinit etj.

3. Disqet që vendosen nën gjuhë, për të kuruar komplikimet e zemrës, **nuk e prishin** agjërimin.

4. Mes dijetarëve ka mospajtime nëse prishet apo nuk prishet agjërimi po që se brenda stomakut hyn diçka joushqyese, si: gur, metal e të ngjashme.

Mendimi më i saktë është se, agjërimi **prishet** vetëm me futjen e gjërave ushqyese.

5. Sipas mendimit më të saktë qëndron se, gastroskopi, që futet në stomak për analiza të ndryshme, **nuk e prish** agjërimin, përveç nëse në të

vendosen lëndë yndyrore ushqyese, në këtë rast **e prish** agjërimin.

6. Të gjithë juristët bashkëkohorë kanë rënë në ujdi se, pirja e duhanit **e prish** agjërimin.

7. Shumica e juristëve bashkëkohorë (si: Ibn Bazi dhe Ibn Uttejmini) thonë se, pikat për hundë **e prishin** agjërimin.

Disa thonë se, nëse vëren shijen e tyre në fyt, e prish, e, nëse jo, nuk e prish.

Ndërkaq, mendimi i autorit është se, **nuk e prish** në asnjë mënyrë.

8. Marrja e oksigjenit **nuk e prish** agjërimin.

9. Për sprejin e hundës vlen gjykimi i sprejit të astmës: domethënë, **nuk e prish** agjërimin.

10. Nëse anestezi i është lokal (mpirje e pjesshme, në ndonjë pjesë të trupit), **nuk e prish** agjërimin, por, nëse është total (i përgjithshëm), rrjedhimisht i sëmuri e humb vetëdijen tërësisht, atëherë ekzistojnë këto raste:

- nëse është gjatë gjithë ditës në mënyrë të vazhdueshme, **e prish**;

- ndërkaq, nëse i sëmuri zgjohet në një pjesë të ditës, agjërimi i tij është **i vlefshëm**.

11. Pikat për veshë **nuk e prishin** agjërimin, sepse nuk ka ndërldhje mes veshit dhe stomakut.

12. Më afër së vërtetës qëndron se, pikat për sy **nuk e prishin** agjërimin.

Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve, si: Ibn Bazit dhe Ibn Uthejmin.

13. Sipas shumicës së juristëve bashkëkohorë, gjilpërat (injeksionet), që merren në lëkurë apo muskuj (si: penicilina, insolina e të ngjashme, të cilat merren në lëkurë apo në muskul), **nuk e prishin** agjërimin.

Ky është mendimi i Ibn Bazit dhe Ibn Uthejmin.

Ndërkaq, gjilpërat që merren në vena apo damarë të gjakut, **e prishin**, sepse përmbajnë ujë dhe lëndë ushqyese, si: kalcium, glukozë etj., e prej tyre trupi ka dobi dhe përforcohet me to ashtu siç forcohet me ushqim e pije.

14. Sipas shumicës së dijetarëve, injeksionet ushqyese, që merren në vena, **e prishin** agjërimin.

Ky është mendimi i Ibn Sadit, Ibn Bazit, Ibn Utnejmin etj.

15. Yndyrat, vajrat, kremrat e ndryshme, llojet e ngjitësve, të cilat përdoren për shërim (zakonisht për lyerje në lëkurë), **nuk e prishin** agjërimin.

Ky është vendimi i Akademisë Ndërkombëtare Fikhore, gjë për të cilën ka ujdi.

16. Lënda ngjitëse që përmban nikotinë duhani (që përdoret si hap ndihmës për ta lënë duhanin), e cila ngjitet në lëkurë, ku lëkura pastaj e thith nikotinën në trup, **nuk e prish** agjërimin sipas mendimit më të saktë.

Ky është edhe vendimi i Akademisë Fikhore Islame dhe mendimi i Ibn Utnejmin.

17. Futja e gastroskopit (gypave të hollë plastikë etj.) në arterie të trupit, qoftë për pastrim, kurim apo fotografim, nuk llogaritet ushqim e as pije, madje as kushtimisht, ndaj nuk arrijnë në stomak, rrjedhimisht, **nuk e prishin** agjërimin.

Ky është qëndrimi i Akademisë Fikhore Islame.

18. Gastroskopi që futet në bark për analiza, operim, nxjerrje të ndonjë mostre për verifikim të ndonjë

sëmundjeje etj., **nuk e prish** agjërimin, sepse nuk arrin në stomak.

19. Nëse pastrimi i veshkave (dializa) shoqërohet me lëndë ushqyese që përmbajnë sheqer etj., s'ka dyshim që **e prish** agjërimin.

Ndërkaq, nëse është vetëm pastrim dhe filtrim i gjakut, pa ndonjë lëndë ushqyese, atëherë **nuk e prish** agjërimin.

20. Pastrimi i organit gjenital (te femrat) përmes gastroskopit vaginal, që përdoret në gjinekologji, **nuk e prish** agjërimin, sepse gjatë këtij pastrimi asgjë nuk arrin në stomak dhe se nuk shkakton diçka që mund ta prishë agjërimin.

21. Supozitori vaginal dhe gastroskopi **nuk e prishin** agjërimin.

22. Nëse në injeksionet anale ka ujë ose lëndë ushqyese dhe sipas mjekësisë konstatohet se zorra e trashë e thith atë, atëherë këto **e prishin** agjërimin, sepse përmes tyre trupi fiton energji.

Ndërkaq, nëse vërtetohet se zorra nuk e thith ujin e as ushqimin apo se këto injeksione nuk përmbajnë ujë e as lëndë ushqyese, atëherë **nuk e prishin** agjërimin.

Këtë mendim ka përkrahur Ibn Uttejmini.

23. Përdorimi i supozitorëve (qirinjve) analë **nuk e prish** agjërimin.

24. Gastroskopi anal **nuk e prish** agjërimin, sepse as arrin në stomak, as është ushqyes, as forcohet trupi me të.

25. Futja e gastroskopit, gypave apo ilaçeve të tjera për pastrimin e fshikëzës së urinës, apo ndonjë lëndë që i ndihmon fotografimit rëntgen për t'u dukur më qartë në kanalin e urinës, **nuk e prish** agjërimin, sepse nuk ekziston kurrfarë lidhjeje apo daljeje mes kanaleve të urinës dhe stomakut.

26. Dhurimi i gjakut i ngjan hixhames (nxjerrja e gjakut të keq nga trupi): mendimi më afërt është se hixhamja **nuk e prish** agjërimin.

Ky është mendimi i shumicës.

Së këndejmi, dhurimi i gjakut **nuk e prish** agjërimin.

27. Marrja e gjakut për analiza të ndryshme, **nuk e prish** agjërimin, sepse në këtë rast nuk ka diç që e shkakton një gjë të tillë.

28. Nëse vjellja shkaktohet pa dëshirën e personit, **nuk e prish** agjërimin. Për këtë ka konsensus (ixhma).

Mirëpo, nëse personi e bën me vetëdëshirë apo e stimulon të vjellët, atëherë **e prish** agjërimin.

Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve, madje imam Ibnul Mundhiri dhe el Hatabi kanë përmendur ixhmain për këtë.

Përmbledhur nga libri: *“Gjërat bashkëkohore që e prishin agjërimin”*.

Përktheu: Agron Krasniqi

<http://t.me/hoxheAgronKrasniqi>